



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2019

**DEKLARATË**  
**PËR CILËSINË E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË QENDRËS SË**  
**SHËRBIMEVE ARSIMORE PËR VITIN 2018**

Unë e nënshkruara Rezana Vrapi, në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe të koordinatorit të riskut të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, deklaroj se kam përgjegjësinë për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jo financiare të njësisë Qendra e Shërbimeve Arsimore si dhe pohoj që sistemi i kontrollit të brendshëm, i ngritur nga Titullari i MASR, mbështet arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë në përputhje me përgjegjësitë që më janë caktuar sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 10296, "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ne cilësinë e Nëpunësit Autorizues deklaroj se kam monitoruar sistemin e kontrollit të brendshëm të Qendrës së Shërbimeve Arsimore gjatë vitit raportues 2018, nëpërmjet vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit për çdo komponent të menaxhimit financiar dhe kontrollit në veçanti, bazuar në orientimet e Kapitujve II dhe III të Manualit "Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" të miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave, Nr.54 date 15.07.2010. Metoda që është përdorur për monitorimin e komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë nëpërmjet raportit për funksionimin e sistemit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit.

Deklaroj nën përgjegjësinë time se raporti bashkëlidhur kësaj deklarate pasqyron në mënyrë të besueshme efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përfshin plan veprimin për trajtimin e mangësive të vërejtura në sistem për të garantuar përmirësimin e tij në vazhdimësi.

Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm është raportuar tek titullari i MASR dhe është diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Nënshkruar nga:

Rezana VRAPI

NEPUNES AUTORIZUES

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Rruga: Naim Frashëri, Nr. 37, Tiranë

Web site: [www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al)

Tel/fax. +355 4 2419257

E-mail: [rezana.vrapi@akp.gov.al](mailto:rezana.vrapi@akp.gov.al)